



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1319/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Naim Ramadani në cilësinë e Kandidatit për Anëtarë të Kuvendit Komunal në Dragash nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të publikimit të rezultateve përfundimtare, në seancën e panelit të mbajtur me 27.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuara ankesa e Naim Ramadani, në cilësinë e Kandidatit për Anëtarë të Kuvendit Komunal në Dragash nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

Arsyetim

PZAP-i, më datën 24.12.2013, ka pranuar një ankesë nga Naim Ramadani në cilësinë e Kandidatit për Anëtarë të Kuvendit Komunal në Dragash nga radhët e subjektit politik LDK, me të cilën pretendon se rezultatet e publikuara nga KQZ-ja nuk janë reale pasi që sipas regjistrimit të publikuar ai është në vendin e 5 të subjektit politik LDK, e që sipas formulave të zbatuara nga komisioni i numërimit ai ka mbetur jashtë listës për asamble. Andaj sipas parashtruesit të ankesës thekson se shkak i animimit të tij është se ndaj tij është zbatuar diskriminimi gjinor pasi që nga 7 anëtarët që i takojnë subjektit të tij politik janë përcaktuar 3 femra të cilat kanë më pak vota se ai e që përbëjnë rreth 43% nga subjekti i tij politik duke u larguar nga pragu 30%, dhe se në këtë mënyrë përmes diskriminimit gjinor në kuvendin e komunës së Dragashit janë përcaktuar 10 femra e që më parë nuk ka qenë asnjëherë më shumë se 9. Parashtruesi i ankesës thekson se përcaktimi i vendeve për kuvend është bërë në kundërshtim me nenin 8 paragrafi 2 Ligjit për zgjedhjet lokale.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstaton se pretendimet ankimore janë të pabazuara dhe të pa argumentuara në fakte dhe në dëshmi bindëse pasi që nga shkresat e lëndës si dhe nga pretendimet e parashtruara në ankesë nuk mund që të vërtetohen pretendimet e tilla ankimore dhe se mbi këtë bazë një ankesë e tillë konsiderohet si e pa bazuar, andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur ankesën e lart përmendur PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 1319/2013 më datën 27.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.